

# ALARM 15

## PUSHTET I SHURDHËR

Gjatë 20 ditëve, prej 28 gusht deri më 17 shtator, kryeministri Gruevski dhe koalicioni i tij qeveritar kanë marrë 5 mesazhe kritike publike nga Berlini, Brukseli dhe Uashingtoni që vlejné si vërejtje publike. Në gjitha këto 5 mesazhe insistohet në liri të medieve. Kryeministri Gruevski dhe koalicioni i tij qeveritar bëhen të paarritshëm për shumë kritika, por veshët e tyre janë më të shurdhër kur bëhet fjalë për lirinë e medieve pa të cilat nuk mund të ketë demokraci.

**28 GUSHT**  
**2014**

Shoqëria qytetare aktive në drejtimin politik mund gjithashtu të sigurojë mbështetje konstruktive në kuptim të përfundimit të mëtutjeshëm të shoqërive demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke i afruar në këtë mënyrë këto vende më afër BE-së. Parakushte për këtë janë skenë plurale mediale, sindikata të pavarura dhe ekonomi, e cila e lirë nga përzierja politike, mund të plotësojë rolin e saj si pjesë e shoqërisë. Gjermania mbetet e dedikuar në përfundimin e **lirisë së medieve** në rajon.

Deklarata përfundimtare e Angela Merkel, kryesuese e Konferencës për Ballkan Perëndimor

**5 SHTATOR**  
**2014**

Mbetemi të dedikuar përpjekjeve për të ndihmuar Maqedoninë të përfundojë mbisundimin e të drejtës, të avancojë **lirinë e medieve** dhe të ndërtojë themele të fuqishme demokratike për një shoqëri inkluzive dhe multietnike.

Deklaratë e sekretarit shtetëror Xhon Keri me rastin e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë

**15 SHTATOR**  
**2014**

Vendet e Beneluksit (Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu) janë shumë të brengosur për stagnacionin, ndërsa në disa fusha edhe ecjen mbrapa, posaçërisht në kuptim të dialogut politik, mbisundimit të së drejtës dhe liritë dhe të drejtat themelore.

.....

**Liria e medieve** praqet një prej vlerave themelore të Bashkimit Evropian. Prandaj, Beneluksi shpreh keqardhje për dialogun e ndërprerë mes qeverisë dhe medieve. Beneluksi në mënyrë energjetike e inkurajon qeverinë të kyçet në dialog konstruktiv me komunitetin e medieve.

Deklaratë e përbashkët e misionit hulumtues nga Beneluksi

**15 SHTATOR**  
**2014**

Zëdhënësi i File thotë që deri sa ajo për të cilën Komisioni është i brengosur nuk merr vëmendjen përkatëse në Maqedoni, siç është **liria e medieve** ose dialogu politik, shumë vështirë është të ndihmohet vendit të avancojë, nëse ajo vetë nuk dëshiron të avancojë.

Deklaratë për MIA e Peter Stano, zëdhënës i Komisarit për Zgjerim i BE-së Shtefan File

**17 SHTATOR**  
**2014**

Gjatë kohës kur Maqedonia zhvillon struktura të fuqishme demokratike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, shtetet tjera mike të Maqedonisë dhe më rëndësishme, vetë qytetarët, shprehin brengosjen për lirinë e shtypit, pavarësinë e gjyqësorit dhe transparenca e financave qeveritare.

.....

**Mediet e lira**, gjyqakë të pavarur dhe paanshme dhe vendimet transparente qeveritare do të forcojnë demokracinë dhe do të promovojnë prosperitetin ekonomik të cilin e synojnë Maqedonasit.

Kandidati për ambasador amerikan në R. e Maqedonisë, Xhes Bejli, në provimin e Komisionit për Punë të Jashtme e Senatit të SHBA-ve

Gjatë këtyre 20 ditëve servilët e medieve të pushtetit të Gruevskit dhe Ahmetit "kanë brohoritur" kundër Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni dhe mbështetjen e saj për disa kritika që këndojnë sipas notave të propagandues qeveritare. „Në rend dhe në korr!“ ashtu i porosit qeveria e Gruesvskit dhe Ahmetit ata që nuk dëgjojnë dhe që assesi nuk kuptojnë që jetojnë në „botën më të mirë nga të gjitha“.



FOUNDATION | ФОНДАЦИЈА  
OPEN | ОТВОРЕНО  
SOCIETY | ОПШТЕСТВО  
MACEDONIA | МАКЕДОНИЈА